

UDHËZIM
Nr. 15, datë 4.6.2026

**MBI PËRDORIMIN E UJIT TË NXEHTË TË RICIKLUAR PËR TË HEQUR
KONTAMINIMIN SIPËRFAQËSOR MIKROBIOLOGJIK NGA KARKASAT¹**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 38, të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Operatorët e biznesit ushqimor lejohen të përdorin ujë të nxehtë të ricikluar për të hequr kontaminimin sipërfaqësor mikrobiologjik nga karkasat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën I, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Udhëzimi i ministrit nr. 15, datë 10.10.2018, “Mbi përdorimin e ujit të nxehtë të ricikluar për të hequr ndotjen sipërfaqësore mikrobiologjike nga karkasa”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, struktura përgjegjëse për inspektimin dhe kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

SHTOJCA I

PJESA I

**KUSHTET E PËRDORIMIT TË UJIT TË NXEHTË TË RICIKLUAR PËR TË HEQUR
KONTAMINIMIN SIPËRFAQËSOR MIKROBIOLOGJIK NGA KARKASAT**

1. Uji i nxehtë i ricikluar duhet të merret nga ngrohja dhe riciklimi i ujit të pijshëm në një sistem të mbyllur dhe të ndarë.

2. Uji i ricikluar t’i nënshtrohet:

a) një ngrohjeje minimale me regjim temperature/kohe përpara aplikimit të tij mbi karkasat, i cili duhet të sigurojë përputhshmërinë me parametrat mikrobiologjik të ujit të pijshëm;

b) një regjim rinovimi në frekuencë të përshtatshme, duke përfshirë, kur është e nevojshme, largimin e grimcave të rënda, filtrimit dhe shtimin e ujit të pijshëm, i cili duhet të sigurojë përputhshmëri me parametrat kimikë të ujit të pijshëm.

3. Uji i nxehtë i ricikluar duhet të aplikohet vetëm mbi karkasat e plota ose gjysmëkarkasat e thundrakëve shtëpiakë dhe kafshëve të mbarështuara të gjahut në kushte të kontrolluara dhe të verifikuara.

4. Uji i nxehtë i ricikluar nuk duhet të aplikohet mbi karkasat me kontaminim të dukshëm fekal.

5. Aplikimi i ujit të nxehtë të ricikluar në karkasë nuk duhet të rezultojë në ndonjë modifikim fizik të pakthyeshem të mishit.

6. Aplikimi i ujit të nxehtë të ricikluar mbi karkasa duhet të kryhet para se karkasat të vendosen në ftohje ose dhomë frigoriferike.

7. Kushtet në pikat 2 dhe 3 të këtij paragrafi të integrohen në procedurat e bazuara në parimet e analizës së rrezikut dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP), duke përfshirë së paku kriteret e përcaktuara në pjesën II të kësaj shtojce.

¹ Ky udhëzim përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit (BE) 2015/1474, të datës 27.8.2015, në lidhje me përdorimin e ujit të nxehtë të ricikluar për të hequr kontaminimin sipërfaqësor mikrobiologjik nga karkasat. CELEX 32015R1474 OJ L 225/7, 28.8.2015.

PJESA II

KRITERET MINIMALE TË HACCP DHE PARAMETRAT E KONTROLLIT

1. Marrja e mostrave në karkasa, me qëllim për të vlerësuar përputhshmërinë me kriteret mikrobiologjike të përcaktuara në udhëzimin nr. 15, datë 9.9.2021, “Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore”, të kryhet para aplikimit të ujit të nxehtë të ricikluar në karkasë.

2. Ngrohja minimale me regjim temperature/kohe i aplikuar për ujin e ricikluar para se të aplikohet në karkasë, të monitorohet vazhdimisht me matje instrumentale, të dokumentuara dhe të regjistruara.

3. Përputhja e ujit të ricikluar të aplikuar mbi karkasat me parametrat mikrobiologjik dhe kimik të përcaktuar për ujë të pijshëm, të verifikohet periodikisht nga testimi i ujit, i dokumentuar dhe i regjistruar.

4. Përputhja e ujit të ricikluar të aplikuar në karkasë me parametrin tregues të ***Clostridium perfringens*** të përcaktuar për ujë të pijshëm të verifikohet nga monitorimi periodik, i dokumentuar dhe i regjistruar.